



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA	KOMUNA • OPSTINA • MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT	
Nr.i Prot.	01
Nr.i Faq.	7653
Data: 27.10.2022	



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 nen 11, 12.2 shkronja (c), 17 shkronja (r), 40, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.10.2022 miraton këtë:

RREGULLORE PËR ADMINISTRIMIN E SHTËPISË SË KULTURËS NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi: Më këtë rregullore, rregullohet statusi juridik i Shtëpisë së Kulturës në Komunën e Hanit të Elezit, konkretisht Shtëpisë së Kulturës "Imri Curri" veprimtaria e Shtëpisë së Kulturës është: organizimi, përfaqësimi, shfrytëzimi, buxheti, ofrimi i ambientit të sigurtë dhe sigurim i të mirave materiale për të gjithë të punësuarit dhe shfrytëzuesëve të pérhershëm e të pérkohshëm dhe transparencë.

Neni 2

Objekti i Rregullimit

Shtëpia e Kulturës është një ndër institucionet kulturore në territorin e komunës së Hanit të Elezit ku ka për qëllim t' i shërbejë formimit kulturor të qytetarëve përmes institacioneve dhe asociacioneve të kulturës. Më këtë rregullore definohen dhe rregullohen qështjet si vijon:

1. Menaxhimi i objekteve publike;
2. Funksionet e objekteve;
3. Të drejtën e shfrytëzimit të objekteve;
4. Të hyrat e realizuara nga shfrytëzimi i objekteve;
5. Procedurat përmarrjen në shfrytëzim të objekteve publike;
6. E drejta e reklamimit;
7. Rendi shtëpiak në objektet e kulturës;
8. Orari;
9. Mirëmbajtja e objekteve të kulturës;
10. Përgjegjësia përmarrjen e shkaktuara në objektet publike dhe
11. Masat ndëshkuese;

Neni 3

Statusi juridik

1. Shtëpia e Kulturës është objekt publik i Komunës së Hanit të Elezit, si objekt i kulturës funksionon në kuadër të Komunës së Hanit të Elezit me veprimtari kulturore dhe edukative.

Neni4

Funksionet dhe Detyrat e Shtëpia te Kulturës:

1. Shtëpia e Kulturës është institucion kulturor dhe informues, që nxisin dhe mundësojnë zhvillimin dhe realizimin e politikave kulturore për të gjithë qytetarët e komunës së Hanit të Elezit.
2. Siguron qasje të lirë dhe ofron shërbim të barabartë për të gjithë qytetarët.
3. Ofrojnë hapësira për shfrytëzim për aktivitete kulturore, për asociacionet dhe institucionet e kulturës, varësisht nga veprimitaria dhe të mirat që sjell për qytetarët e Komunës së HANIT TË ELEZIT.
4. Shfrytëzuesit me afat të gjatë janë vetëm institucionet që janë themeluar nga Kuvendi i Komunës ose në përputhje me ligjin për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
5. Shfrytëzuesit e përkohshëm janë asociacionet që kanë kërkesë paraprake dhe lidhin marrëveshje me Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për kohë të caktuar.
6. Në Shtëpinë e Kulturës mund të zhvillohen aktivitete kulturore si dhe promovuese dhe tubime nga fusha politike.

Neni 5

E drejta për shfrytëzimin e Shtëpisë së Kulturës

1. Të drejtë shfrytëzimi të shtëpisë së kulturës e kanë: Institucionet shtetërore, ansamblet kulturore, trupa teatrale, organizatat joqeveritare, organizatat politike, institucionet shkollore, Universitetet, Shtëpitë Akademike, institucionet ndërkombëtare si dhe grupet tjera formale dhe joformale.
2. Ansamblet dhe trupa teatrale duhet të sjellin orarin e tyre për shfrytëzimin e sallës te menaxheri i shtëpisë së kulturës.

Neni 6

Mënyra e shfrytëzimit të Shtëpisë së Kulturës

1. Mënyra e shfrytëzimit të shtëpisë së kulturës rregullohet me anë të marrëveshjes së arritur në mes palës së interesuar me menaxherin e objektit të shtëpisë së kulturës, e cila nënshkruhet nga menaxheri i shtëpisë së kulturës dhe palës së interesuar.
2. Organizatat të cilat obligohen të bëjnë pagesa sipas nenit 14, duhet të marrin formularin e fletëpagesës në organin kompetent të DKRS-së.
3. Pagesat realizohen nëpërmjet xhirollogarisë komunale dhe ato konsiderohen si të hyra vetanake.
4. Organizatat kulturore dhe jokulturore duhet të paraqesin një kërkesë zyrtare, planin e punës, lejen e njoftimit të personit përgjegjës dhe certifikatat e organizatës (regjistimet fiskale).
5. Kërkesat shqyrtohen nga organi kompetent i DKRS-së, sipas nenit 7, pas pranimit të kërkesës jepet përgjigja në afatin ligjor sipas legjisacionit në fuqi.
6. Organi kompetent jep pëlqim për zhvillimin e aktiviteteve të tjera për të cilat nuk parashihen të nënshkruhen në kontratë.

Neni 7

Kërkesa për shfrytëzim

1. Pala e interesuar për shfrytëzim të shtëpisë së kulturës duhet të paraqes kërkesë së paku 3 (tri) ditë, para mbajtjes së aktiviteteve.
2. Kërkesa i drejtohet me shkrim menaxherit të shtëpisë së kulturës, i cili obligohet për të kthyer përgjigje me shkrim brenda 24 orëve.
3. Ansambleve të qytetit dhe trupat-teatrale, që janë të regjistruar në komunën tonë dhe që kanë kalendarin e rregullt të aktiviteteve kulturore nuk i nënshtron paragrat 7.2.

Neni 8

Mirëmbajtja e Shtëpisë së Kulturës dhe sallave sportive jashtë procesit mësimor në shkolla

1. Për mirëmbajtjen e përgjithshme të objekteve obligohen OJQ-të, klubet sportive, shoqatat kulturore dhe shoqatat tjera.
2. Asociacionet kulturore që arrijnë marrëveshje me DAKRS-në, qoftë si përfitues të mbështetjes financiare nga thirrja publike apo ndonjë formë tjetër, për shfrytëzim në kohë të caktuar, njëkohësisht kujdesen edhe për mirëmbajtjen e hapësirave në shfrytëzim.
3. Të gjithë shfrytëzuesit të cilët shkaktojnë ndonjë dëmtim eventual, do të gjobiten apo do të riparojnë dëmtimet e shkaktuara.

Neni 9

Menaxhimi i Shtëpisë së Kulturës

- 1.** DAKRS-ja duke u bazuar në organogramin sipas procedurave të konkursit publik angazhon (menaxher) si dhe punonjës sipas procedurave të shërbimit civil, për përkujdesjen e objekteve lidhur me koordinimin e aktiviteteve.
- 2.** I punësuari (menaxheri) i cili emërohet dhe pranohet konform ligjeve në fuqi për punësim, emërohet me detyrë në Shtëpinë e Kulturës “Imri Curri” dhe menaxhon Shtëpinë e Kulturës në komunën e Hanit të Elezit.
- 3.** Të hyrat potenciale, që mund të gjenerohen nga Shtëpia e Kulturës, sallave sportive, përkatësisht tarifat që do të vendosen nga institucioni në fjalë, janë të rregulluara me këtë rregullore.
- 4.** Përgjegjës për menaxhimin dhe dhënien në shfrytëzim të Shtëpisë së kulturës eshtë Komuna e Hani i Elezit respektivisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
- 5.** DAKRS në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive eshtë e obliguar që nëpërmjet zyrtarëve të këtij Drejtoreti në mënyrë të vazhdueshme të vizitojë dhe kontrollojë objektet e Shtëpisë së kulturës dhe të mbajë procesverbal duke evidentuar gjendjen faktike si dhe parregullsitë apo dëmet eventuale.

Neni 10

Detyrat dhe përgjegjësítë

- 1.** Përgjegjësi (menaxheri) udhëheq, organizon funksionin e Shtëpisë së Kulturës në bazë të përshkrimit të detyrave që i takojnë;
- 2.** Kujdeset për rendin Shtëpiak të këtyre institucioneve të kulturës;
- 3.** Harton oraret për shfrytëzimin e hapësirave nga asociacionet e kulturës;
- 4.** Mbikëqyrë mirëmbajtjen e objekteve;
- 5.** I raporton (Shefit të Kulturës) të DAKRS-se për çdo mangësi, avari ose mos disiplinë.
- 6.** Menaxheri/Menaxherja brenda një muaji të afatit kohorë i dërgon, raport me shkrim DAKRS-së.

Neni 11

Administrimi i qasjes në Shtëpinë e Kulturës

- 1.** Në ndërtesa kanë qasje, stafi i DAKRS-së;
- 2.** Anëtarët dhe lexuesit e bibliotekës;
- 3.** Anëtarët e Shoqërive dhe Asociacioneve, përfaqësuesit e OJQ-ve
- 4.** Stafi politik dhe personeli ndërkombëtar, punëtorë kontraktues që kryen punë në Shtëpi të Kulturës.
- 5.** Qytetarët në ditët e caktuara për ndjekjen e programeve kulturore.

Neni 12

Objekti i Shtëpisë së Kulturës "Imri Curri"

1. Funksionimi dhe selia e Shtëpisë së Kulturës "Imri Curri" është në Han të Elezit, rr. "Nuri Bushi". Hapësira e brendshme posedon: sallën me 450 ulëse, sallën e leximit, sallën e takimeve, 15 zyre, dhoma për ondulim dhe zhveshtore për meshkuj dhe femra.
2. Hyrja në Shtëpinë e Kulturës "Imri Curri" përfshinë: Hyrja fizike, hyrja e lirë, e kufizuar, me qelës.
3. Në hyrje të Shtëpisë së Kulturës, "Imri Curri" është vendosur, recepcionistët (rojet), të cilët bëjnë identifikimin dhe evidentimin e zyrtarëve, shfrytëzueseve dhe vizitorëve tjerë. Recepcionistët evidentojnë kohën e hyrjes dhe daljes së vizitorëve.
4. Fletoren e recepcionistit, do 24 orë e kontrollon dhe e nënshkruan, menaxheri i shtëpisë së kulturës.
5. Hyrjet dhe daljet e zyrtarëve dhe të gjithë shfrytëzuesve të Shtëpisë së Kulturës, janë nën vëzhgimin e kamerave;

Neni 13

Ndalesat gjatë qëndrimit në Shtëpi të Kulturës (rendi Shtëpiak)

1. Reptësisht ndalohet pirja e duhanit, brenda hapësirave;
2. Reptësisht ndalohet konsumimi i alkoolit;
3. Reptësisht ndalohet përdorimi i drogës dhe lëndëve narkotike;
4. Reptësisht ndalohet hyrja e individëve të cilët tentojnë të hynë në Shtëpinë e Kulturës nën ndikimin e alkoolit ose drogës si dhe të gjithë atyre që posedojnë, pije alkoolike, narkotike dhe armë;
5. Për pakënaqësitë eventuale, shfrytëzuesi duhet të drejtohet me ankesë në DAKRS;
6. Menaxheri i shtëpisë së kulturës ka të drejtë të suspendojë përkohësisht shfrytëzuesin e sallës për mos respektimin e kritereve të përcaktuara në marrëveshje dhe rregullave sipas dispozitave të kësaj rregullore deri në vendim tjetër të DAKRS-së;
7. Shfrytëzuesi i shtëpisë së kulturës duhet të identifikohet dhe të regjistrohet çdo herë para shfrytëzimit të sallës dhe të respektojë orarin e caktuar në marrëveshje me personat përgjegjës në shtëpinë e kulturës;
8. Ansamblot dhe individët duhet vetë të kujdesen për gjërat e tyre personale, menaxhmenti nuk mban përgjegjësi për gjërat e humbura apo të dëmtuara;
9. Shfrytëzimi i shtëpisë së kulturës bëhet me pagesë sipas tarifës së caktuar me këtë rregullore, përjashtim bëjnë vetëm subjektet e liruara;
10. Shitja e rekuizitave, pijeve, ushqimeve dhe gjërave tjera në objektin e Shtëpisë së kulturës është e ndaluar.
11. Ndalohej vendosja e posterëve dhe njoftimeve tjera pa leje me shkrim nga ana e menaxherit të shtëpisë së kulturës.

Neni 14

Pagesat për shfrytëzim të objektit në shtëpinë e kulturës (Sallë)

1. Ansambljet, trupa teatrale, OJQ-të që ushtrojnë veprimtari kulturore, që janë të regjistruara në DAKRS, janë të liruar prej pageset në shfrytëzimin e sallës.

2. Për aktivitetet politike (fushata zgjedhore, tubime, organizime me karakter politik):

2.1. Për 1 orë	20 €
2.2. Për 2 orë	35 €
2.3. Për më tepër se dy orë	50 €
2.4. Për tërë ditën	100€

3. Nga shfrytëzimi i sallës dhe hapësirës së arteve:

3.1. Për ngjarje komerciale {eksposita, revy dhe të ngjashme) 100€

3.2. Për ngjarje humanitare..... (gratis)

3.3. Për koncerte të ndryshme 30% nga inkasimi i mjeteve prej biletave ose pagesë fiksë sipas marrëveshjes.

4. Të hyrat nga anëtarësimi i lexuesve:

4.1. Anëtarësimi për fëmije (Klasa e I-IX) për një vit(pa pagesë).

4.2. Anëtarësimi për të rritur 10 €.

4.3. Anëtarësimi për studentë..... 5 €.

4.4. Në rast të humbjes apo thyerjes së librezës, duhet të nxirret libreza e re duke paguar 50% të çmimit kushtues të librezës origjinale.

Lirim nga pagesa:

5.1. Anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve;

5.2. Invalidët dhe veteranët e luftës së UÇK-së (familja e ngushtë);

5.3. Personat me aftësi të veçanta;

5.4. Personat me asistencë sociale;

5.5. Parashkollarët, fëmijët bonjakë (të braktisur) dhe pensionistët;

5.6. Lexuesit e degave të bibliotekës në fshatra;

5.7. Anëtarësimi në datat kalendarike ndërkombëtare të librit;

5.8. Dhuruesit e gjakut;

5.9. Punonjësit e bibliotekës.

Neni 15

Masat ndëshkuese

1. Ndaj palëve të cilët nuk e respektojnë rendin Shtëpiak dhe nuk i binden menaxhmentit të objektit do të merren masa ndëshkuese;

1.1. Suspendim i përkohshëm nga e drejta e shfrytëzimit të shtëpisë së kulturës me kohëzgjatje të lirë për t'u përcaktuar nga përgjegjësi i objektit dhe nëse përsëritet më shumë se dy herë i njëjtë veprim, atëherë i merret e drejta për shfrytëzim, derisa subjekti ose organizata në fjalë është i përbërë nga të njëjtë akterë;

1.2. Për dëmet eventuale të shkaktuara nga subjekti apo organizatat tjera përkatëse, përgjatë kohës së zhvillimit të aktivitetit përgjegjësia bie te shfrytëzuesi, i cili duhet ti bëjë kompensimet në afat prej (5) ditëve në xhirollogarinë e komunës së Hanit të Elezit. Sipas dispozitave të parapara në marrëveshjen për shfrytëzim të objektit;

1.3. Dëmet e shkaktuara vlerësohen nga komisioni ad-hoc prej tre anëtarëve i emëruar nga DAKRS-ja. Në rast të mos kompenzimit të dëmeve në afatin e paraparë sipas paragrafit (2) të këtij nenit, iniciohet procedura gjyqësore përmes përbaruesit privat duke përfshirë edhe kamatën ligjore si dhe ndalesën për shfrytëzim deri në zgjedhjen e kontestit.

Neni 16

Ndryshimi në strukturën (objektin) të Shtëpia të Kulturës

1. Ndalohet ndryshimi i hapësirave dhe paisjeve të palëvizshme, pa njoftimin e menaxherit dhe pa lejen e DKR-së, respektivisht në sektorin e kulturës;

2. Ndalohet dëmtimi i qëllimshëm i gjelbrimit dhe hapësirës së parkingut.

Neni 17

Parkingu

1. Të gjithë të punësuarve në Shtëpinë e Kulturës, ju lejohet, parkimi i automjeteve në oborrin e saj.

2. Gjatë zhvillimit të aktiviteteve edhe qytetarët kanë të drejtë shfrytëzimit të parkingut.

Neni 18

Sigurimi i Shtëpisë së Kulturës

1. Sigurimi fizik i hapësirave të Shtëpisë së Kulturës "Imri Curri", oborrit dhe parkingut, bëhet dhe monitorohet 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë nga personat kompetentë për siguri;
2. Të gjitha kopjet e çelsave të hapësirave janë të vendoșura në zyrën e recepcionistit ku ata qëndrojnë;
3. Në rast të rrezikut të hapësirave të Shtëpisë së Kulturës, ndërhyr personat kompetentë dhe urgjentisht njoftohen:
 - 3.1. Policia
 - 3.2. Zjarrëfiksët
 - 3.3. Menaxheri
 - 3.4. Shefi i Kulturës
- 3.5. Numrat e kontaktit të këtyre personave duhet të jenë të vendosur në ndonjë tabelë njoftuese në hapësirat e brendshme të Shtëpisë së Kulturës.

Neni 19

Dispozitat Kalimtare dhe përfundimtare

1. Zbatimin e kësaj rregullore nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës e bënë Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
2. DAKRS-ja është e obliguar që t'i pajisë me një kopje (fizike apo elektronike) të rregullores të gjitha palët që i shfrytëzojnë objektet kulturore publike.
3. Ndryshimet dhe Plotësimet e rregullores i bën vetëm Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit.

Neni 20

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Hani i Elezit
Data: 27.10.2022

